

Është paraparë që gjatë ditës së premte (sot) në Kosovë të mbërrijnë 30 mbetjet mortore të kosovarëve të gjetura në varrezën masive në Rashkë të Serbisë. Por, këto mbetje nuk do të mbërrijnë të paktën deri më 26 gusht. Kjo pasi që pala serbe e përfaqësuar nga Komiteti i Kryqit të Kuq ndërkombëtar, ka kërkuar nga pala kosovare që fillimisht të njoftohen familjarët e këtyre viktimave dhe pastaj të procedohen mbetjet te pala kosovare.

Prenkë Gjetaj nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore të Kosovës, ka thënë se pala serbe ka përcjellë kërkesën dhe se e njëjta është duke u shqyrtuar nga pala kosovare. Sipas tij, java e ardhshme është data e fundit për dorëzim të mbetjeve. “E kemi vendos datën 26 ose javën tjetër si datë të fundit në të cilët pala serbe do të na i dorëzojë mbetjet e rreth 30 eshtrave të viktimave të vrara gjatë luftës së fundit në Kosovë”, ka thënë Gjetaj.

Sipas tij, nga raportet ka të dhëna se është rritur numri i mbetjeve mortore dhe se gjatë gërmimeve gjurmuesit kanë hasur në mbetje të reja.

“Tani në raporte kemi parë se kanë ardhur edhe identifikime të tjera. Mbi 30 mbetje, viktimat të luftës do të riatdhesohen. Ne po presim përgjigje nga pala serbe e përfaqësuar nga komiteti ndërkombëtar nëse pajtohen për këtë çështje”, ka thënë Prenkë Gjetaj, për gazetën Tribuna.